

BREAKING NEWS

A DO TË JETË E DETYRUESHME VAKSINA ANTI-COVID? MINISTRJA E SHËNDETËSISË JEP PËRG

AKTUALITET

Ndjekje si në filma në Shkodër, 2 të arrestuar për trafik droge, në Durrës përfundojnë në pranga 3 të tjerë

SHKRUAR NGA ALBIONA LIPO
14 NËNTOR 2020




Një operacion i zhvilluar nga Policia Kufitare e Shkodrës ka “goditur” dje dy të rinj, të cilët janë arrestuar, pasi gjatë kontrollit në mjetin e tyre janë gjetur lëndë narkotike kanabis si dhe janë përpjekur të kalojnë kufirin në mënyrë të paligjshme. Po ashtu burime nga policia bëjnë të ditur se është shpallur në kërkim edhe një 23-vjeçar, i cili është bashkëpunëtor në këtë vepër penale. Konkretisht policia njofton se ky operacion është kryer në vendin e quajtur “Shina-Hidrovor”, teksa gjatë patrullimeve tre të rinj janë konstatuar të dyshimtë, në një mjet tip “Ford”. Këta të fundit pasi kanë pikasur vëzhgimet e policisë janë përpjekur të largohen drejt Hidrovorit me mjetin e tyre. Më tej policia njofton se, në tentativë për t’u arratisur ata kanë braktisur mjetin duke u larguar mes zonës së pyllëzuar, por kjo tentativë ka dështuar pasi në ndjekje të tyre, policia ka mundur të kapë dhe arrestojë dy prej tyre ndërsa një tjetër është shpallur në kërkim. “Shërbimet e Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit, në kuadër të masave të shtuara për parandalimin dhe goditjen e krimeve ndërkufitare, si rezultat i kontrolleve të shtuara në kufirin e gjelbër, në bashkëpunim dhe me Seksionin për Hetimin e Narkotikeve dhe Trafiqeve në DVP Shkodër, kanë finalizuar me sukses operacionin “Hidrovori”, si rezultat i të cilit u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve: E. I. 26 vjeç, banues në Shemri, Kukës dhe D. Zh. 19 vjeç banues në Kalimash, Kukës. Si dhe është shpallur në kërkim shtetasi E. D. 23 vjeç, banues në Shemri, Kukës. Në vendin e quajtur “Shina-Hidrovor”, nga punonjësit e Policisë Kufitare, gjatë patrullimeve të shtuara është konstatuar një mjet tip “Ford”, drejtuesi i të cilit, në momentin që ka parë punonjësit e Policisë, ka shtuar shpejtësinë e mjetit duke lëvizur në drejtim të Hidrovorit. Menjëherë, punonjësit e Policisë janë vënë në ndjekje të automjetit. Shtetasi E. D. braktisi mjetin dhe bashkë me dy pasagjerët tentoi të largohej në zonën e pyllëzuar në teren malor”, deklaroi policia. Ndërkohë, gjatë kontrollit të ushtruar në mjet, shërbimet e Policisë kanë gjetur rreth 1.5 kg lëndë të dyshuar narkotike cannabis sativa cilat janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale. Ndërsa, materialet procedurale do t’i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, për veprën penale “Trafikim i narkotikeve”, kryer në bashkëpunim dhe “Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror”.


Arrestohen 3 persona në Durrës

Ndërkohë, po ditën e djeshme në pragat e Policisë së Durrësit, kanë rënë edhe tre persona të tjerë të cilët kanë tentuar të kryejnë shitblerjen e një sasive kokaine, në një lokal në lagjen nr. 13, Plazh, teksa gjithashtu gjatë kontrollit janë konstatuar edhe municione luftarake. “Specialistët për Hetimin e Narkotikëve në DVP Durrës, në bashkëpunim me Forcat Operacionale, në vijim të punës për goditjen e veprimtarisë kriminale të shpërndarjes së drogave të forta, në bazë të informacioneve të siguruar në rrugë operative, zhvilluan dhe finalizuan me sukses operacionin policor të koduar “Pure drugs”, në kuadër të të cilit u arrestuan në flagrancë shtetasit: A. G., 42 vjeç, A. N., 34 vjeç dhe F. D., 20 vjeç, i dënua më parë për veprën penale “Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt”, banues në Durrës. Gjatë operacionit, në bazë të informacioneve të siguruar se këta shtetas po tentonin të kryenin shitblerjen e një sasive kokaine, shërbimet e Policisë kanë konstatuar në një lokal në lagjen nr. 13, Plazh, Durrës, këta tre shtetas duke shkëmbyer 1 kg e 113.5 gr. lëndë narkotike të dyshuar kokainë. Në vijim të operacionit, gjatë kontrollit në banesën e shtetasit A. N., shërbimet e Policisë kanë gjetur një krehër dhe 33 fishekë”, deklaroi policia.


Më të lexuarat




Vaksina anti-COVID, ekspeti nxjerr bluf Manastirliun: COVAX s'ka asnjë lidhje me Moderna-n dhe Pfizer




Aksident tragjik në aksin rrugor Milot-Rrëshen, ka të vdekur




“Mos më trash mua zërin”, plas sherri në studio mes zv.ministrit dhe ekspertit: Ju jeni injorant totalisht!




Imunologu Genc Sulçebe zbulon detajin e rëndësishëm për të gjithë, tregon se kush janë personat që nuk kanë nevojë që ta bëjnë vaksinën anti-Covid




Gara për Gjykatën Kushtetuese, KED ndalon kandidaturat e 3 gjyqtarëve (EMRAT)




Çfarë duhet të bëjmë pasi kalojmë Covid-19? Mjeku shqiptar në Londër ka një këshillë për qytetarët




Koronavirusi të prek dy herë? Shefi i Laboratorit të Mikrobiologjisë: Deri tani janë vetëm tre raste të vërtetuara. Ja çfarë dimë për imunitetin




U vra nga RENE, deputeti i kërkon llogari ministrit Dendias për Kacifas: Shqipëria s'mund të hyjë në BE pa...




Plas sherri në burgun grek, 5 shqiptarët bëjnë për spital të riun, e godasin me sende metalike dhe shkop druri



I preu fytin 7-vjeçares në park/ 30-vjeçarja shqiptare i shokon të gjithë me deklaratën në seancën gjyqësore



Gjendet i vvarë me armë zjarri në banesë i riu në Durrës, policia jep detajet e para: Ja çfarë dyshojmë



E rëndë! 29-vjeçarja shtatzënë ndërron jetë nga koronavirusi

Mesazhe Promocionale

Gossip



■ ■ ■ ■ ■ ■ ■

Dalin pamjet! Stresi përfundon i zhveshur me vajzën misterioze, dyshja, thuajse lakuriq në një dhomë

Këngëtari Arkimed Lushaj i njohur ndryshe si Stresi është ...

Opinione

SEVO TARIFA
Duke jetuar ditë të bardha, s’duhen harruar di...

BARDHYL BEJKO
Koronavirusi do ikë nga frika e komitetit me tr...

GJON NEÇAJ
Politikanë, jo çdo gjë është ashtu siç duket.....

GJON BRUÇI
Mos u mundoni t’i vini buzëkuq sistemit të zi k...

LEXO OPINIONE TE TJERA